

## **Thirrje e hapur për pjesëmarrje në trajnimin “Iniciativa e burrave të rinj” për gratë dhe burrat e rinj**

A je grua e re apo burrë i ri entuziast/e, dhe e/i gatshme/ëm për t'i zhvilluar njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet?

Je duke kërkuar përvojë të dorës së parë në trajtimin e pabarazive dhe diskriminimit gjinor, praktikave të dëmshme dhe parandalimin e formave të tjera të dhunës në baza gjinore mes adoleshentëve përmes një trajnimi edukativ?

Misioni i OSBE-së në Kosovë, në bashkëpunim me CARE International dhe organizatat lokale partnere Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmohatarë dhe Sinergija, është duke mbështetur “Iniciativën e burrave të rinj” në ofrimin e një trajnimi njëditor për gra dhe burra të rinj (16 -30 vjeç) në Kosovë. I akredituar nga Ministria e Arsimit, Teknologjisë dhe Shkencës, “Iniciativa e burrave të rinj” është program në mbarëkombëtar i krijuar për të promovuar zgjedhje të shëndetshme jetësor për burra të rinj dhe djem dhe për të luftuar normat e ngurta sociale dhe gjinore.

Trajnimi pritet të mbahet më 6 prill, ndërsa vendndodhja do të bëhet e njohur pas përzgjedhjes së grupit.

Nëse jeni të interesuar të merrni pjesë, ju lutemi dërgoni rezymenë tuaj dhe një letër motivimi tek:

Faton.Ajeti@osce.org

Trajnimi është menduar të forcojë kapacitetin e të rinjve në ndërtimin e qëndrimeve më të barabarta dhe sjelljeve të ndjeshme gjinore në lidhje me normat shoqërore patriarkale të pranishme në mjedisin e tyre të përditshëm. Adolehenca paraqet një cikël të rëndësishëm të jetës në procesin e socializimit kur qëndrimet dhe sjelljet janë ende në zhvillim e sipër. Prandaj, ky trajnim synon të ngritë vetëdijen mbi kulturën toksike mashkullore dhe të zhvillojë tolerancë zero ndaj sjelljeve të tilla tek burrat e rinj/djemtë dhe gratë e reja/vajzat. Prandaj, fuqizimi i burrave dhe grave, djemve dhe vajzave për t'i njohur dhe kundërshtuar me sukses normat e dëmshme shoqërore, duke shfrytëzuar njohuritë dhe shkathtësitë e tyre, do të çojë në vendimmarrje efektive që kontribuon në zgjidhje të shëndoshë dhe pa dhunë të problemeve relacionale dhe promovon një shoqëri me barazi më të madhe.

Afati për aplikime: 27 mars 2019.